



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05-350/02-55047/26 dt. 16.04.2026 (sipas e-Leja KKN-00981), në emër të aplikuesve Fazli Villasaliu, nga Prishtina me investitor “Koral Invest” L.L.C., me seli në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “F-11”, të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perendimore”, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 425-0 ZK Cagllavicë, sipas projekt propozimit “zgjidhjes urbane” të prezantuar.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 22.07.2026 deri më 06.08.2026, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, me etazhitet B+P+8
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	29.90 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	29.90 m` / 0.5 H ose min. 7m pa hapje
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP=40 %, e lejuar për blloku “F-11”
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN=2.0, e lejuar për “F-11”
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISHGJ= 40 %, e kërkuar sipas Vendimit të Kryetarit, nëse aplikohen kulmet e gjelbërta duhet të sigurohet 30% në nivel të parterit
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHN=60 %, e lejuar për “F-11”
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	vendparkime të jashtme dhe nën tokë 280
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Po
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
n. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____